



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr.2 Datë 10.05.2007

PËR
MIRATIMIN E PJESËMARRJES INFLUENCUESE TË SHOQËRISË “SIGAL
HOLDING SH.A” AKSIONER I VETËM I SHOQËRISË SË SIGURIMIT “SIGAL
SH.A”, SI REZULTAT I TRANSFERIMIT TË AKSIONEVE DHE MIRATIMIN E
NDRYSHIMEVE TË STATUTIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT “SIGAL
SH.A.”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 23, të Ligjit nr.9572, datë 3.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, dhe nenit 56 dhe 57 të Ligjit nr.9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime”, me propozim të Departamentit të Liçensimit dhe Monitorimit, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

- 1. Miratimin e pjesëmarrjes influencuese të shoqërisë “Sigal Holding sh.a” aksioner i vetëm i shoqërisë së sigurimit “Sigal sh.a.”, si rezultat i transferimit të aksioneve.**
- 2. Miratimin e pjesëmarrjes influencuese të z.Avni Ponari si aksioner jo i drejtpërdrejtë, por nëpërmjet shoqërisë “Sigal Holding sh.a”, si rezultat i zotërimit të aksioneve nga 29% në 45%, në shoqërinë e sigurimit “Sigal sh.a”.**
- 3. Miratimin e ndryshimit të statutit të shoqërisë së sigurimit “ Sigal sh.a.”, si reflektim të pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi.**

4. Ngarkohen shoqëria e sigurimit “Sigal sh.a.” dhe Sektori i Licensimit në AMF, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim i bëhet i njohur drejtorisë së shoqërisë “Sigal sh.a”.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit.


KRYETARI

Elisabeta GJONI

NËNKRYETARI

Ermela GUXHOLLI

